

# MEMO

<i>Datë:</i> 25 Korrik 2020	
<b>Për: Armend Zemaj,</b>  Ministër i Shëndetësisë	<b>Nga: Lul Raka,</b>  Kryesues i Bordit Këshillëdhënës për Covid-19
<b>RAPORT NGA MBLEDHJA E DYTË E BORDIT KËSHILLËDHËNËS PËR COVID-19</b>	

## **PËRMBLEDHJE E QËNDRIMEVE TË BORDIT KËSHILLËDHËNËS ANTI-COVID 19**

- Të miratohet urgjentisht Ligji anti-Covid 19
- Të fuqizohet koordinimi dhe menaxhimi në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor
- Të ngritet vetëdijësimi i popullatës dhe komunikimi i rrezikut
- Të vazhdohet me testime PCR në komunitet
- Të shtohen kapacitetet mbikqyrëse të inspektorateve me procedurë urgjente
- Të hapen çerdhet
- Të lejohet lutja e Festës së Bajramit
- Varrimet: të hiqet arkivoli hermetik dhe në vend të tij të përdoret arkivoli i zakonshëm i mbyllur
- Nuk rekomandohet përdorimi i tunelëve dezinfektues në shkolla dhe institucione tjera jomjekësore
- Gastronomia-restorantet propozohet të punojnë deri në ora 22.30
- Të lejohet veprimtaria e sporteve individuale dhe bazeneve të brendshme

**PRIORITETI KRYESOR: PËRQËNDRIMI I AKTIVITETEVE NË MJEKIMIN E TË SËMURËVE ME COVID-19**

**PARIMET**

1. Prioritet absolut është përqëndrimi i përpjekjeve në mjekimin e të sëmurëve me Covid-19
2. Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale në SHSKUK dhe ndërlidhja efektive me kujdesin parësor shëndetësor
3. Vetëdijësimi i vazhdueshëm i popullatës për rëndësinë e zbatimit strikt të masave parandaluese
4. Fuqizimi i kapaciteteve testuese
5. Aktivitetet në periudhën e ardhshme të bazohen në hapjen e kontrolluar dhe të mbikqyrur të shoqërisë

**AKTIVITETET**

1. Të fuqizohet koordinimi dhe menaxhimi në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor
2. Ngritja e kapaciteteve mbikqyrëse të inspektoratit shëndetësor dhe inspektorateve tjera me procedurë urgjente
3. Themelimi i shërbimit profesional të sëmundjeve ngjitëse brenda SHSKUK në bazë të legjislacionit në fuqi që do të sigurojë menaxhimin efikas, të koordinuar, dhe integruar të kapaciteteve profesionale në nivelin parësor, dytësor dhe tretësor të sistemit shëndetësor
4. Zyrtarizimi dhe përditësimi i UPK për Covid-19

## SFONDI

---

Situata epidemiologjike në vendin tonë ka pësuar një përkeqësim pas lirit të masave, duke u radhitur ndër vendet me incidencën më të lartë në Evropë. Dy faktorët kryesor të rritjes së numrave janë mosrespektimi masiv nga qytetarët dhe mungesa e mbikqyrjes dhe kontrollit rigoroz nga shteti. Kultura dhe mentaliteti janë pjesë të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë në intervenim.

Prioriteti themelor në përgjigje është identifikimi i kombinimit të masave që njëkohësisht e kontrollojnë infeksionin dhe në të njëjtën kohë e mbrojnë aspektin socio-ekonomik. Këtë ekuilibër e përcaktojnë resurset ekzistuese, mentaliteti, besimi në qeverisje, vetëdijësimi i popullatës, etj.

Sipas të dhënave të IKSHPK, në Kosovë, 50.5% e rasteve të konfirmuara janë asimptomatikë. Pjesa më e madhe e rasteve janë raste të kontakteve familjare (71.4%). Pasonë rastet në institucionet publike (14.3%) dhe institucionet shëndetësore (10.9%).

Përqindja e imunitetit në vendet me prekje masive-Spanjë, Francë, etj. ka qenë vetëm 5%. Suedia, e cila ka pasur qasje më liberale, edhe pse ka pasur edhe ajo restriksione ka imunitet vetëm 7%. Studimi i publikuar këtë javë në Shqipëri tregoi se në Tiranë vetëm 7% e popullatës e kanë kaluar sëmundjen. Për të arritur të ashtuquajturin “imunitet kolektiv” duhet të preken 60-70% e popullatës, por kjo shkon me mijëra të vdekur. Kjo qasje nuk është etike, e arritshme dhe nuk zbatohet askund në botë.

Me këtë numër të ulët të personave që e kanë kaluar sëmundjen, pjesa dërmuese e popullatës mbeten të ndjeshëm dhe kurdo pas çdo izolimi total, **nëse s’ka mbikqyrje rigoroze nga shteti**, do të ketë rishfaqje të njëjtë të numrave. Izolimi total nuk është opcion për fazën aktuale për shkak të pasojave në shkatërrimin e ekonomisë, shëndetit mental dhe dhunës përcjellëse në familje.

**Qasja e Bordit është hapja e kontrolluar me respektim dhe inspektim strikt të masave themelore parandaluese: distancë fizike, maska dhe higjienë. Të gjitha propozimet e Bordit janë miratuar unanimisht për të gjitha pikat pas një debati përmbajtësor.**

[https://www.researchgate.net/publication/342861508\\_Pathophysiology\\_Transmission\\_Diagnosis\\_and\\_Treatment\\_of\\_Coronavirus\\_Disease\\_2019\\_COVID-19\\_A\\_Review](https://www.researchgate.net/publication/342861508_Pathophysiology_Transmission_Diagnosis_and_Treatment_of_Coronavirus_Disease_2019_COVID-19_A_Review)

[https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(20\)31483-5/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(20)31483-5/fulltext)

## **PROPOZIMET E BORDIT:**

### **1. TË MIRATOHET URGJENTISHT LIGJI ANTI-COVID 19**

---

Korniza ligjore aktuale është e pamjaftueshme për ta adresuar një prej pikave kryesore të masave parandaluese- maskën. Dënimet aktuale me ligjin në fuqi prej 1000 Euro ose burgim 2-12 vjet janë joracionale. Sankcionet duhet t'i përshtaten xhepit të kosovarëve dhe mund të jenë ekuivalente me dënimet në komunikacion. (p.sh. në Holandë mosbartja e maskës në mjete transporti dënohet me 95 Euro, kurse mosmbajtja e distancës fizike prej 1.5 m dënohet me 390 Euro).

Në përballjen me COVID-19, por edhe me epidemitë e tjera që mund të shfaqen në të ardhmen e afërt dhe të paraqesin kërcënim të shëndetit publik, nevojitet një bazë ligjore, e cila do ta fuqizojë mbikëqyrjen epidemiologjike, masat e parandalimit dhe kontrollit, testimin, trajtimin dhe kujdesin, resurset e nevojshme, masat kufizuese dhe ato sanksionuese, por që nuk bien ndesh me konventat ndërkombëtare për te drejtat e njeriut.

### **2. TË FUQIZOHET KOORDINIMI DHE MENAXHIMI NË TË GJITHA NIVELET E KUJDESIT SHËNDETËSOR**

---

#### **SHSKUK**

- Të fuqizohet koordinimi në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor dhe secili të merr përgjegjësitë e veta sipas autorizimeve dhe shërbimit përkatës. Ky koordinim të bëhet me takime të rregullta javore.
- Të rriten kapacitetet humane në institucionet e mbingarkuara me mjekë dhe infermierë të rinj
- Për shkak të stërlodhjes së stafit shëndetësor në klinikat që merren me trajtimin e pacientëve me COVID-19, të bëhet transferi i stafit nga klinikat e tjera të SHSKUK më pak të ngarkuara
- Të motivohet stafi shëndetësor dhe ai mbështetës përmes stimulimit financiar
- Punëtorëve shëndetësorë në klinikat që merren me pacientë me COVID-19 t'u jepet pushim.
- Të sigurohen pajisje personale mbrojtëse për stafin shëndetësor dhe atë ndihmës. Të sigurohen maska N95 për punëtorët shëndetësorë që gjinden në ballë të reagimit për shkak të rritjes së numrit të rasteve në mesin e punëtorëve shëndetësorë.
- Të mbahen trajnime obligative (të akredituara) për punëtorët shëndetësorë, me theks në stafin e ri.

- Të sigurohet terapia për trajtimin adekuat të pacientëve me COVID-19. AKPM të marrë përgjegjësinë institucionale për trajtimin e Covid-19
- Të aprovohet urgjent udhërrëfyesi dhe protokoli klinik kundër COVID-19
- Të aktivizohen me të gjitha pajisjet perkatese njësitë e kujdesit intensiv në të gjitha spitalet rajonale
- Të shikohet mundësia e koncentrimin të pacientëve në një hapësirë të madhe Intensive Covid-19. Kjo do ta lehtësonte menaxhimin duke patur parasysh numrin e vogël të anesteziologëve. Aktualisht janë 3 njësi intensive që marrin nga 3 ekupe. Tentimi për bartje të pacientëve nga intensiva në mjekësinë sportive ka hasur në probleme për shkak të rënies së presionit të oksigjenit.
- Me rritjen e numrit të pacientëve të rëndë dhe duke patur parasysh numrin e vogël të anesteziologëve, është e domosdoshme të trajtohen me urgjencë edhe mjeket tjere, së paku menaxhimin e rrugëve të frymëmarrjes dhe aplikimin e mbështetjes respiratore me CPAP maskë (njëjtë kanë vepruar shumica e vendeve të Evropës).
- Të fillohet procedura për trajtimin e pacientëve me Covid-19 me plazmën e personave konvaleshentë
- Të ndalohet rreptësisht hyrja e familjarëve tek pacientët me COVID 19. Kjo duhet të përcillet me ngritje të resurseve humane në klinika për ta adresuar gamën e mbingarkesës së punëtorëve shëndetësorë.
- Të vendoset policia apo sigurimi në institucionet shëndetësore që trajtojnë pacientë me Covid-19
- Komiteti Etik i SHSKUK të jetë kompetent për hulumtimet klinike në vend
- Në spitalet rajonale të kyçen pulmologët dhe internistët në menagjimin e pacientëve me COVID-19

### **IKSHPK**

- Të shfrytëzohet platforma digjitale Go-Data
- Të themelohet një grup i profesionistëve (duke i ftuar edhe ata jashtë institucioneve), ekspertë të pavarur vendorë e ndërkombëtarë, që të punojnë në planin e koordinuar të hulumtimeve për COVID-19.
- Laboratori molekular të përfshihet në kontrollën e jashtme të cilësisë
- Të zbatohet Plani për rritje të kapaciteteve të testimit PCR në Prishtinë dhe në institutet rajonale
- Të ndahen specializime të Mikrobiologjisë sipas kërkesës së Departamentit të Mikrobiologjisë

- Të pranohen edhe 8 laborantë të rinj në punë, përmes të cilëve do të mundësohej puna në 3 ndërrime
- Te ngriten kapacitetet e mikrobiologjisë klinike në klinikën infektive në laboratorin e hapur në shkurt të këtij viti. Mikrobiologu i punësuar tashmë punon në PCR me ekipin e IKSHPK
- Të mos bëhet testimi i personave të aksidentuar në COVID dhe as në obduksion pa indikacione të qarta
- Unifikimi dhe standardizimi i të dhënave të pacientëve për testim dhe për pacientët e konfirmuar me COVID19
- Punimi me kohë i testeve dhe marrja e rezultatit në kohën më të shkurtër të mundshme
- Testimet e punëtorëve shëndetësor të jenë prioritet dhe të bëhen brenda ditës
- T'u jepet me shkrim rezultati i testimit me PCR pacientëve që e kërkojnë

### **Kujdesi Parësor Shëndetësor**

- Ekipet mjekësore të kthehen prej pikave kufitare në institucionet e tyre përkatëse në kujdesin parësor.

Stafi mjekësor është ballafaquar shpesh me mungesë të kushteve adekuate për punë dhe pamundësi për ekzaminim adekuat të qytetarëve (me përjashtim të matjes së temperaturës). Që nga lirimi i rundit të tretë të masave nuk ka pasur asnjë rast të dyshuar për COVID19, që është referuar në klinikën Infektive direkt nga kufiri.

- Në QKMF të krijohen qendrat e kujdesit për pacientë me Covid-19

### **3. NGRITJA E VETËDIJËSIMIT TË POPULLATËS**

Qasja e popullatës përmes mohimit të ekzistimit të virusit me teoritë e ndryshme konspirative ka sjellë dëm në adresimin publik të përbaljes me COVID-19. Prandaj, ky segment duhet të fuqizohet me një strategji të fortë e komunikimit të rrezikut, me të cilën duhet t'i rikujtojë qytetarët se pandemia nuk ka mbaruar.

- Në vetëdijësimin e popullatës të kyçen figura autoritative nga fusha të ndryshme të jetës (artistë, këngëtarë, sportistë, etj.)

- Të përfshihet në edukim edhe shoqëria civile dhe personat që e kanë mbijetuar sëmundjen.
- Përmes CIVIKOS platformës, të kontaktohen OJQ-të që kanë ekspertizë dhe përvojë që të bashkangjiten në mobilizimin e komuniteteve dhe në monitorimin e veprimeve institucionale (shëndetësore, arsimore, të rendit dhe ligjit dhe menaxhimit të financave).

#### **4. TË VAZHDOHET ME TESTIME PCR NË KOMUNITET VARËSISHT SIPAS KAPACITETEVE TESTUESE**

---

Testimi laboratorik i saktë dhe në kohën e duhur është një prej shtyllave të përgjigjes së sistemit shëndetësor në menaxhimin e COVID-19. Mungesa e testeve dhe reagjentëve e pengon përgjigjen efikase ndaj epidemisë. Prej ditës së parë e deri në fund të pandemisë, Kosova do të ballafaqohet me pengesa serioze në furnizimin me teste PCR për shkak të kërkesave enorme që tejkalojnë shumëfish kapacitetet njerëzore e infrastrukture.

Rritja e numrit të rasteve në javët e fundit ka shtuar kërkesat për testim përtej kapaciteteve ekzistuese në IKSHPK. Nëse merret në konsideratë se për çdo rast pozitiv ka mesatarisht 36 persona të kontaktit dhe të gjithë ata dëshirojnë të testohen, i bjen që në 100 raste të konfirmuara, kërkesat ditore për testim të jenë afër 3600 teste në ditë. Kjo ka shtyrë IKSHPK, që testimi të bëhet sipas rradhës së prioriteteve. Prioritetet dhe kriteret për testim janë dhënë nga IKSHPK dhe janë përmbledhur në shtojcat 1 dhe 2.

Qasja e bazuar vetëm në diagnozën klinike (covid like disease) mund të aplikohet vetëm në mungesë të theksuar të testeve laboratorike PCR. Simptomatologjia e COVID-19 po bëhet gjithnjë e më komplekse dhe sensitiviteti i kësaj qasje është i ulët.

Rastet tipike të zbatimit të kësaj qasje mund të jenë kur një anëtar i familjes tashmë është testuar pozitiv dhe ndërkohë familjarët që qëndrojnë në të njejtën shtëpi me të zhvillojnë simptoma. Familjarët e tjerë nuk testohen (përveç rasteve të sëmundjeve kronike dhe shtatzënave).

Këto raste duhet të veçohen si raste të dyshuara klinike dhe nuk përfshihen me rastet e konfirmuara laboratorike.

ECDC ka formuluar opcionet kryesore për reagim që ndërlidhen me testimet pas rishfaqjes së rasteve në shumë shtete të Evropës me theks në Ballkanin Perëndimor:

- Strategji e zgjeruar e testimit, që synon testimin gjithëpërfshirës të të gjithë individëve që shfaqin simptoma të COVID-19.
- Kornizë për gjurmimin e kontakteve, të bazuar në testime të gjera, gjetjen aktive të rasteve, zbulim të hershëm të rasteve, izolimin dhe karantinimin e tyre dhe përcjelljen e vazhdueshme të kontakteve.

- Identifikimi i shpejtë dhe hetimi i vatrave të epidemisë të lidhura me mjedise specifike (shtëpi të pleqve, institucione shëndetësore, etj.), me zbatimin e masave të rregullta parandalimit dhe kontrollit .

ECDC, <https://www.ecdc.europa.eu/en/covid-19/surveillance/testing-strategies>

OBSH, [https://www.who.int/publications/i/item/global-surveillance-for-human-infection-with-novel-coronavirus-\(2019-ncov\)](https://www.who.int/publications/i/item/global-surveillance-for-human-infection-with-novel-coronavirus-(2019-ncov))

<https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/RRA-Resurgence-of-reported-cases-of-COVID-19-in-the-EU-EEA.pdf>

### *Të lejohen laboratorët private për testimet PCR dhe ato serologjike*

Laboratorët private të licencohen edhe për teste molekulare edhe serologjike. Testimi molekular do ta rriste numrin e testeve ditore dhe do ta zbuste kërkesën enorme për testim që është evident javëve të kaluara.

Testimi në sektorin privat do të ofronte shërbim për qytetarin e Kosovës që kërkon ta dijë statusin e vet shëndetësor me COVID-19 qoftë aktual (me testimin PCR) apo të kaluar (me teste serologjike). Në këtë kategori do të mund të testo heshin personat që kanë kërkesa për udhëtim në pushime verore (siç ka pasur kërkesa për Mal të Zi), kërkesat e bashkëatdhetarëve për rikthim në shtetet ku jetojnë, studentët kosovarë në Maqedoni apo edhe testimet tjera pa asnjë indikacion klinik.

Në sektorin privat, duke i testuar personat që nuk kanë simptoma, do të mund të zbuloheshin edhe personat pozitivë asimptomatikë, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në përhapjen e sëmundjes. Prandaj, në këto raste diagnostika do të ndihmonte në gjurmim të rasteve dhe parandalimin e sëmundjes.

Këto laboratorët duhet të mbikqyren rreptësisht nga organet kompetente të MSH dhe t'i plotësojnë të gjitha kriteret bazë siç janë: biosiguria, stafi, infrastruktura dhe përmbushja e standardeve të kontrollit të cilësisë. Rezultatet të raportohen në IKSHPK dhe MSH.

## **5. NGRITJA E KAPACITETEVE MBIQYRËSE TË INSPEKTORATEVE ME PROCEDURË URGJENTE**

**Inspektim rigoroz i të gjitha institucioneve dhe ndërmarrjeve afariste për zbatimin e masave**

- MASKAT duhet të jenë OBLIGATIVE



Shumë të infektuar me koronavirus nuk kanë fare simptoma (asimptomatikë). Disa të tjerë që shfaqin simptoma, mund ta bartin virusin tek të tjerët para shfaqjes së simptomave (presimptomatikë). Në Kosovë, 50.5% e rasteve të konfirmuara janë asimptomatikë. Kjo shifër është edhe më e madhe nëse merret parasysh se kohëve të fundit është vendosur që të mos testohen fare këta persona.

Prandaj, masa e domosdoshme parandaluese është përdorimi obligativ i maskës. Kjo qasje njëkohësisht e parandalon edhe sëmundjen edhe ruan ekonominë dhe shëndetin mendor.

- Të blihen maska shumëpërdorimëshe nga shteti dhe të shpërndahen tek kategoritë sociale
- Në mungesë të maskave këshillohet përdorimi i mbulesave të fytyrës. Këto mbulesa për fytyrë mund të përgatiten nga materiale dhe rroba të ndryshme dhe të lira në shtëpi.
- Maska patjetër të shoqërohet me dy masat tjera parandaluese: distancën fizike dhe higjienën e duarve.

<https://jamanetwork.com/journals/jama/fullarticle/2768532>

[https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(20\)31142-9/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(20)31142-9/fulltext)

<https://journals.plos.org/plosmedicine/article?id=10.1371/journal.pmed.1003166>

<https://www.pnas.org/content/early/2020/07/02/2008373117>

## 6. TË HAPEN ÇERDHET

---

Të hapen çerdhet, me zbatim të udhëzimeve profesionale për parandalim të sëmundjes në çerdhe dhe mbikqyrje e inspektim rigoroz të masave. Udhëzohet MASHT dhe MSH që sa më parë të rishikojnë dhe plotësojnë udhëzimin për rihapjen e çerdheve.

Fëmijët preken shumë më pak se të rriturit nga Covid-19. Shkalla e prekjes së fëmijëve është nën 2%, kurse a tyre të moshës së çerdheve në Kosovë është 2% . Pika e parë e kontaktit të SARS-CoV-2 me trupin e njeriut është në epitelin e hundës. Ekspresioni i ulët i receptorëve ACE2 të fëmijët, krahasuar me atë më të theksuar të rriturit mund të japë përgjigjen pse COVID-19 është më pak i pranishëm te fëmijët.

Po, ashtu shkalla e infektiozitetit të fëmijëve është shumë e ulët.

Shkalla e rrezikut të infektimit është më e lartë në disa segmente të hapura si qendrat tregtare apo gastronomia. Komponentat përkeqësuese të mbylljes janë edhe : ndikimi në shëndetin mental të fëmijëve, reflektimi në prindërit e tyre, qëndrimi në ambiente tjera gjatë ditës ku ka rrezik shumë më të madh sesa në çerdhe etj.

[https://jamanetwork.com/journals/jama/fullarticle/2766524?fbclid=IwAR0TWPXkoBY9CAIT8m4bB272\\_Teh3BMKQAghIRUY9vTw2M3cI-rsqjQHFzc](https://jamanetwork.com/journals/jama/fullarticle/2766524?fbclid=IwAR0TWPXkoBY9CAIT8m4bB272_Teh3BMKQAghIRUY9vTw2M3cI-rsqjQHFzc)

<https://www.nature.com/articles/s41591-020-0962-9>

## **7. TË LEJOHET LUTJA E FESTËS SË BAJRAMIT**

---

Këshillohet që Lutja e Festës së Bajramit të bëhet në pajtim me rregullat e BIK duke respektuar rekomandimet në vijim:

- Lutja të realizohet në mjedise të hapura
- Lutja brenda xhamive të mundësohet për numër të kufizuar të qytetarëve sipas normës 2 metër distancë në mes personave
- Të gjithë personat duhet të jenë me maska (ose mbulesa të fytyrës)
- BIK siguron mekanizmat për respektimin e këtyre masave
- Qytetarët këshillohen që të shmangin vizitat familjare gjatë festës

## **8. PROTOKOLET E VARRIMIT**

---

Varrimi - të hiqet arkivoli hermetik dhe në vend të tij të përdoret arkivoli i zakonshëm i mbyllur .

<https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-safe-handling-of-bodies-or-persons-dying-from-COVID19.pdf>

## **9. NUK REKOMANDOHET PËRDORIMI I TUNELËVE DEZINFEKTUES NË SHKOLLA DHE INSTITUCIONE TJERA JOMJEKËSORE**

---

• Spërkatja e individëve me dezinfektues (si p.sh. në një tunel, kabinet apo dhomë) nuk rekomandohet në asnjë rrethanë).

Spërkatja me klor dhe kimikate të tjera mund të rezultojë në irritim të syve dhe lëkurës, bronkospazëm për shkak të inhalimit dhe simptoma gastrointestinale (mundim dhe vjellje). Kjo metodë nuk e zvogëlon aftësinë e një personi të infektuar për të përhapur virusin përmes spërklave ose kontaktit. Nuk ka dëshmi se rrobet janë vektor i rëndësishëm i përhapjes së koronavirusit.

Nëse qëllimi është të sulmohet virusi që ndodhet në rrugët e frymëmarrjes, nuk ka dëshmi se aplikimi 20-30 sekondësh është efikas dhe i sigurtë. Përdorimi i tunelit dezinfektues mund të jep ndjenjën e rrejshme të sigurisë dhe si rrjedhojë ata mund t'i zbatojnë më pak masat tjera vitale për parandalim (distance fizike, maskë, higjiena e duarve). Në këto

institucione është qenësore pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve, të cilat preken më së shpeshti.

<https://ëëë.ëho.int/publications-detail/cleaning-and-disinfection-of-environmental-surfaces-inthe-context-of-covid-19>

10. **GASTRONOMIA**-Restorantet propozohet të punojnë deri në ora 22.30.

Hapësira e shfrytëzueshme për një person të jetë 4 m<sup>2</sup>.

### 11. TË LEJOHET VEPRIMTARIA E BAZENEVE TË BRENDSHME

Klubet e notit lejohen ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në bazenet e mbyllura. Rreziku është shumë më i madh në bazenet e hapura, në të cilat mund të ketë numër të madh të njerëzve gjatë ditëve të nxehta.

Sipas kategorizimit të rrezishmërisë së sporteve, noti hyn në kategorinë më të ulët edhe për shkak të përdorimit të klorit si dezinfektant në bazene. Ky aktivitet të zhvillohet konform masave parandaluese të dhëna nga MSH.

- Të lejohen sportet individuale.

**PJESËMARRËSIT NË TAKIM:**

1. Salih Ahmeti
2. Muharrem Bajrami
3. Xhavit Rexhaj
4. Sanije Xhemajli
5. Ferid Agani
6. Isme Humolli
7. Pashk Buzhala
8. Xhavit Gashi
9. Besim Kodra
10. Lul Raka

Munguan me arsye: Isuf Dedushaj dhe Rukije Mehmeti

## SHTOJCAT

### SHTOJCA 1: REKOMANDIMET PËR TESTIM

1. Të gjitha rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive dhe repartet e dedikuara për pacient me COVID-19;
2. Pacientët në repartet e Pulmologjisë dhe Kujdesit Parësor Shëndetësor me infeksione të rënda respiratore;
3. Personeli shëndetësor me shenja dhe simptoma të infeksionit si dhe personeli që ka pasur kontakt të afërt dhe të pambrojtur me persona të konfirmuar me SARS CoV-2;
4. Kontaktet e afërta të personit COVID-19 pozitiv, të cilët kanë shenja dhe simptoma të COVID-19 (nuk testohen personat asimptomatikë, por udhëzohen në vetizolim 14 ditë si dhe monitorim vetanak të gjendjes shëndetësore);
5. Personat e moshuar dhe personat me sëmundje kronike (sëmundje të mushkërive, kancer, insuficiencë të zemrës, sëmundje cerebrovaskulare, sëmundje renale, sëmundje të mëlçisë, hipertension, diabet dhe gjendje imunokompromituese) të cilët kanë shenja të infeksionit akut respirator;
6. Të gjitha rastet e dyshuara që kanë shenja klinike në SARI në komunitet apo institucionet e mbyllura (shkolla, spitale, shtëpi të pleqve, burgje);

### SHTOJCA 2: KRITERET PËR SHENJAT DHE SIMPTOMET E SËMUNDJES QË KËRKOHEN PËR TESTIM

Testimi laboratorik për COVID-19 duhet të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

Pacientët me infeksion akut të traktit respirator (fillimi i papritur i sëmundjes me të paktën njërin këto shenja e simptoma: kollë, ethe, frymëzënie) ose shfaqje e papritur e anosmisë (humbje e shqisës së nuhatjes), ageusia (shijes) ose dëshmi radiologjike që tregojnë leziona kompatible me COVID-19

DHE

Një histori udhëtimi ose vendbanimi në një vend / zonë, ku ka pasur vatra të rasteve

ose përhapje në komunitet gjatë 14 ditëve para fillimit të simptomave;

OSE

Kontakt i ngushtë me një rast të konfirmuar ose të mundshëm COVID-19 në 14 ditët e fundit para fillimit të simptomave;

OSE

Personi që kërkon hospitalizim.

OSE

Personi është banor ose anëtar i stafit, në një institucion rezidencial për personat e cenueshëm, në 14 ditët para fillimit të simptomave.